

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Efektivët "ia qëlluan", kokaina 2 milionë euroshe që u kap në Portin e Durrësit i përkiste vrasësit të "të fortit" të Tiranës, dy të tijët prapa hekurave (E PLOTË)
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/efektivet-ia-qelluan-kokaina-2-milione-euroshe-qe-u-kap-n-e-portin-e-d-i401290
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 19:13:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 19:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5bacd299bc709c022dad9cafc090f4e7fa0c02c0fbcaeaaff25c0dc747828cd6
TEKSTI	80d51c8301cbd99ce0060112b5ad44b8a3ae99857aa6e80b0ec76e94594fe3
PAMJA	964207eeca52ffc4cda6faa543e2ac2c69a98ff8bdab4ba383bbdee21c10b62e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bfa96ad301160de5f53ed6b83e42d160d1748ce28dcb649f0b3f6015b89819d0
E MËPARSHMJA	db51f85563af8eb3d443ed27e1204ffb05fc3630a1d8febda4039323cdd7b42f
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bfa96ad301160de5f53ed6b83e42d160d1748ce28dcb649f0b3f6015b89819d0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



12 numrat e parë FALAS!
Version PDF



Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Aktualitet

15 Shtator 2026, 21:06

Efektivët "ia qëlluan", kokaina 2 milionë euroshe që u kap në Portin e Durrësit i përkiste vrasësit të "të fortit" të Tiranës, dy të tijët prapa hekurave (E PLOTË)

Shkruar nga Newsbomb



Gert Gjenerali, kokaina e sekuestruar

Detaje të reja kanë dalë në pah nga operacioni policor i zhvilluar dje në portin e Durrësit, ku efektivët pikasën dhe sekuestruan rreth 41 kilogramë kokainë me vlerë më shumë se 2 milionë euro e fshehur në kontejnerat e mishit.

Droga e sekuestruar raportohet se i përkiste shqiptarit mjaft të njohur në botën e krimit, Gert Gjeneralit i njohur ndryshe si "Gjenerali", i cili është dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e të konsideruarit si i forti i Tiranës, Naim Zyberi, në vitin 1997 në Itali.

Goditja e trafikimi të dhjetarë kilogramë kokainë drejt Shqipërisë u finalizua pas një hetimi 1 vjeçar, ku bëhet me dije se autoritetet Belge lëshuan disa masa sigurie, ndërsa pak më parë ata kishin rënë në gjurmët e një 48 vjeçari, i identifikuar si **Arben. U.**, që kishte lidhje me Gert Gjeneralin.

Referuar hetimeve të kryera, 48-vjeçari në fjalë dyshohet të jetë ndërmjetësi mes grupeve nga Shqipëria dhe Amerika Latine për importimin e kokainës, përfshirë këtu dhe portin e Antwerpit.

"Një trafikant droge shqiptar, i cili ishte në procesin e krijimit të linjave të reja

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

Rama ndan FOTO-ALBUMIN nga vizita në Napoli, kryeministri merr dhuratë "veten e tij" në miniaturë



Rajoni

Kosova "sy e veshë" nga Haga nesër, spitali kryesor i Prishtinës merr masa

Zbulo më shumë artikuj >

telefonike, u pergjua ne apartamenti e tij ne Berchem, Antwerp, per muaj te tere. Kjo jo vetem qe e çoi policinë te të dyshuarit e tjerë, por zbuloi gjithashtu se burri shqiptar ishte në kontakt me një të dyshuar për vrasje, i cili është kërkuar në Itali për gati tridhjetë vjet. Të katër të dyshuarit u paraqitën para gjyqtarit hetues këtë mëngjes. Dy prej tyre mbeten në paraburgim dhe dy të tjerë kërkuar pezullimin e procedurave" shkruajnë **mediet e huaja** në lidhje me ngjarjen.

Zëdhënësi i Zyrës së Prokurorit Publik të Antverpit, Kristof Aerts: "Burri në të dyzetat dyshohet se koordinoi grupet e ndryshme përgjegjëse për dërgesën, rikuperimin dhe shpërndarjen e drogës. Ai thuhet se ofroi metoda të ndryshme për kontrabandën e drogës, mund të kërkonte ndihmën e, për shembull, rojeve të sigurisë dhe drejtoi korrierët."

Sakaq bëhet me dije se të mërkurën e javës që lamë pas autoritetet e huaja vunë në pranga ndërmjetësin Arben U. Së bashku me të, shtatë të dyshuar të tjerë në Antwerp, Berchem, Deurne, Kapellen, Bruksel, Evere, Sint-Agatha-Berchem dhe Sint-Joost-ten-Node. Katër prej tyre u përballën me gjyqtarët e huaj, përfshirë këtu shqiptarët Arben U. dhe bashkëpunëtorin e tij **Gertjan B.** Ky i fundit ishte liruar nga burgu vetëm një muaj më parë, ku kishte vuajtur një dënim për trafik droge.

Ndërsa bëhet me dije se dyshja mëngjesin e sotëm u lanë në paraburgim, masë e cila do të rishikohet më tej nga dhoma e gjyqtarëve ditën e premte. Siç kemi raportuar dhe ditën e djeshme, ngarkesa prej 41 kilogramë kokainë që u kap në Durrës dyshohet se i përket këtij grupi, në krye të të cilit përmendet shqiptari i dnëuar me burgim të përjetshëm, Gert Gjenerali.

"Port, Durrës/ Goditet një rast i trafikimit të kokainës nga Brazili drejt Shqipërisë.

Brenda një muaji goditen 3 raste të tentativës për të futur lëndë narkotike në Shqipëri, nëpërmjet Portit të Durrësit.

Në kuadër të operacionit policor të koduar "Anchor 3", sekuestrohen 41 kg e 350 gramë kokainë, me vlerë tregu rreth 2 milionë euro.

Operacioni u zhvillua nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve i DVP Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës dhe strukturat doganore të Portit të Durrësit, në kuadër të hetimeve për një rast të trafikimit të lëndëve narkotike.

Në Portin e Durrësit, shërbimet e Policisë kryen kontroll të imtësishëm në një kontejner me origjinë nga Brazili, i cili, sipas dokumentacionit, transportonte mish pule.

Gjatë kontrollit të kontejnerit, në kapakët e jashtëm të tij u konstatuan 37 paketime me lëndë të dyshuar narkotike kokainë.

Sasia totale e lëndës së dyshuar narkotike rezultoi 41 kg e 350 gramë, ndërsa vlera e saj përlogaritët rreth 2 milionë euro.


Strukturat hetimore të DVP Durrës vijnë veprimet për dokumentimin e plotë ligjor të rastit, përcaktimin e origjinës dhe destinacionit të lëndës narkotike, si dhe identifikimin dhe kapjen e shtetasve të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme" njoftoi dje Policia.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





E Martë 21:11

"Kryekuzhinieri i çorbës së derrit është vetë kryeministri", Artan Hoxha "shpërthen": Kur do Rama bëhet drejtësia, kur s'do nuk bëhet



Aktualitet

Nga fusha në tregun europian, Ministri i Bujqësisë: Toka mbetet e jotja, makineritë dhe tregu të përbashkëta

E Martë 20:03



Aktualitet

E reja zbuloi SKANDALIN, Zegjineja thyen heshtjen për ngjarjen me dajën: I ati i Meritës ishte kundër! Dënoj çdo lloj dhune (REAGIMI)

E Martë 19:16



E Martë 17:50

I dënuar për dhunë, arrestohet 44-vjeçari shqiptar në Itali



Aktualitet

Apeli i dha lirinë në 2020, Gjykata e Lartë kthen për rigjykim dosjen e Ergys Kolaverit, donte të merrte gjakun e vëllezërve



Aktualitet

MIRATOHET drafti i PS për pagat e magjistratëve të "Ligjet", kalon në Kuvend këtë të enjte

E Martë 17:16



E Martë 17:15

Aksident i rëndë në Lezhë-Shkodër! Përplasen tre makina, raportohet për tre të plagosur (PAMJE NGA VENDNGJARJA)



Aktualitet

Aksident i rëndë në Maqellarë-Peshkopi, plagosen pesë persona, katër prej tyre nisen me urgjencë drejt Tiranës

E Martë 17:11 Newsbomb



Aktualitet

U arrestua dy muaj më parë, Gjykata e Tiranës vendos për ekstradimin e turkut të akuzuar për tentativë vrasje në Zvicër (EMRI)

E Martë 16:34



E Martë 16:15

Nisin punimet në Bypassin e Elbasanit, Karakaçi në terren: I jep zgjidhje trafikut të krijuar në autostradën Tiranë-Elbasan





Aktualitet

Gjykata e Brazilit MIRATON ekstradimin e Ervin Matës, kushtet që Shqipëria duhet të plotësojë për të marrë “bolin e kokainës”


🕒 E Martë 15:40



Aktualitet

Protestat në Shqipëri, ambasadori i Kroacisë mesazh qeverisë: Dëgjoni zërin e qytetarëve

🕒 E Martë 15:25



Aktualitet

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.